



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 3797 prot.

Pogradec, më 18.09.2023

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

Znj. MANJOLA KAMOLLI
KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po Ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues: të projektvendimit “ Për “Zgjerimin e sipërfaqes së varrëzave publike për qytetin në fshatin guras dhe blerjen e sipërfaqes se tokës së nevojshme për funksionimin e këtij shërbimi”.

Me respekt,

KRYETARI
Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 1 (Nje).

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 2 (Dy)

Nr. i i fletëve A4 të dokumentave shoqeruese: 15 (Pesëmbdhjete).

Nr. i kopjeve: 3 (Tre)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. ____ prot.

Pogradec, më ____ . ____ 2023

PROJEKT-VENDIM
Nr. ____, DATË ____ / ____ /2023

PËR
ZGJERIMIN E SIPËRFAQES SË VARRËZAVE PUBLIKE PËR QYTETIN NË
FSHATIN GURRAS DHE BLERJEN E SIPËRFAQES SE TOKËS SË NEVOJSHME
PËR FUNKSIONIMIN E KËTIJ SHËRBIMI.

Bazuar në ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 8, pika 1, neni 9, pika 1.2., gërma a) dhe c), neni 23, pika 7, neni 54, gërma k), neni 64, gërma gj), ligjit nr. 8743, datë 22/02/2001, „Për pronat e paluajtshme të Shtetit“, i ndryshuar, neni 5, ligji nr. 162/2020, „Për prokurimin Publik“, neni 7, pika 1, gërma a), Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë nenet 83, 705 e vijues me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1. Shtrirja e sipërfaqes së varrezave të reja publike për qytetin me vëndndodhje në fshatin Guras duke shtuar një sipërfaqe totale prej 6.590 m², sipas hartës bashkangjitur.
2. Blerjen nga ana e Bashkisë Pogradec e pronave të nevojshme për shtrirjen e varrezave të reja të qytetit me vëndndodhje Guras për pronat si më poshtë:
 - 2.1. Prona me nr. Pasurie 321/20, Zona kadastrale 1711, me sip. 800 m².
 - 2.2. Prona me nr. Pasurie 321/21, Zona kadastrale 1711, me sip. 1.090 m².
 - 2.3. Prona me nr. Pasurie 321/6, Zona kadastrale 1711, me sip. 1.000 m².
 - 2.4. Prona me nr. Pasurie 321/25, Zona kadastrale 1711, me sip. 3.700 m².
3. Çmimi I blerjes së sipërfaqes do jetë çmimi prej 366 lek/m² (Çmim I dakortësuar edhe me pronarët me referencë sipas procedurës për shpronësim publik shpallur me kërkesë nr. 476/8, datë 23/06/2023 për "Ndërtimin e rrugës lidhëse Pogradec-Drilon. Lot 2").
4. Autorizohet Kryetari I Bashkisë të nënshkruajë kontratat e shit blerjes së sipërfaqeve të mësipërme përpara noterit duke respektuar në përgjithësi kushtet e kontratës bashkangjitur këtij vendimi, sipas formateve të përcaktuara në ligjin nr. 110/2018 "Për Noterinë".
5. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe administrata e Bashkisë për kryerjen e procedurave ligjore për regjistrim.
6. Ky vendim hy në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

MANJOLA KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT, KONTROLLIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
SEKTORI MONITORIMIT ZBATIMIT KONTRATAVE, ZBATIMIT KUSHTEVE TE LEJES DHE SHPRONESIMEVE

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____. _____. 2023

Relacion

**PËR ZGJERIMIN E SIPËRFAQES SË VARRËZAVE PUBLIKE PËR QYTETIN NË
FSHATIN GURRAS DHE BLERJEN E SIPËRFAQES SE TOKËS SË NEVOJSHME
PËR FUNKSIONIMIN E KËTIJ SHËRBIMI.**

TË NDERUAR KËSHILLTARË !

Projekt vendimi I cili paraqitet përpara jush është një domosdoshmëri për realizimin e shërbimit publik të funksionimit të varrezave publike e përcaktuar nga neni 23, pika 7 e ligjit organik nr. nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore". Ashtu si kemi informuar vazhdimisht, për qytetin e Pogradecit janë në funksionim 2 varreza publike, një i ndosur në Unazën e qytetit, rruga e Vërdovës dhe varrezat e tjera shtrihen në territorin e Njësisë administrative Gështenjas në afërsi të ish pularisë në Guras. Prej vitesh varrezat e qytetit kanë ezauruar kapacitetin maksimal të tyre dhe varrimet e pjesës më të madhe të personave që ndërrojnë jetë kryhet në varrezat e reja, pranë ish-pularisë në Guras. Shfrytëzimi i varrezave të reja ka filluar prej së paku 13-14 vitesh dhe sipërfaqja e tokës në dispozicion të Bashkisë Pogradec në këto varreza është në ezuarim. Sipërfaqja ekzistuese është dhënë prej vitesh nëpërmjet shpronësimit publik të realizuar me emergjencë si pasojë e shkarrjes së varrezave në atë kohë dhe u realizua me qëllim zgjidhjen e emergjences, ndërkohë sot është e domosdoshme zgjerimi i sipërfaqes së paku me 4 parcela me rreth 6.590 m². Për këtë qëllim kërkohet në pikën e parë të projekt vendimit miratimi juaj për zgjerimin e sipërfaqes së këtyre varrezave me këto 4 parcela të cilat do ti japin mundësi Bashkisë të realizojë shërbimin e varrimit dhe për një periudhë rreth 10 vjecare.

Njëkohësisht, në bashkëpunim me Agjnesinë Shtetërore për Shpronësimin, është konkluduar mundësia e blerjes së këtyre parcelave direkt nga ana e Bashkisë për shkak se shpronësimi publik ka procedurë e cila zakonisht zgjat nga 1.5 deri në 2 vjet, ka kosto shtesë mbi vlerat e shpronësuar dhe rezultati i kostove financiare finale me blerje direkte është me ekonomik pasi zona ku ndodhen parcelat kanë vlerë tregu për m², të njëjtë me vlerën që do paguhet për shkak të shpronësimit dhe më e rëndësishmja pronarët kanë shprehur dakortësimin e tyre për ta tjetërsuar të drejtën e pronësisë. Theksojmë se për shkak të zonës ku ndodhen parcelat, vlera totale e blerjes ka një kosto rreth 2.400.000 lek te reja, vlerë kjo e pakonsiderueshme për shërbimin që do të ofrohet dhe emergjencën që zgjidh në afat kohor të shpejtë.

Këshilli i Bashkisë ka të drejtën e blerjes së pasurive direkt nga pronarët, mbështetur në dispozitat e nenit 5, të ligjit nr. 8743, datë 22/02/2001, „Për pronat e paluajtshme të Shtetit“, i ndryshuar, neni 8, pika 1, neni 9, pika 1.2., gërma a) dhe c), neni 23, pika 7, neni 54, gërma k),

dispozita të cilat i njohin të drejtat e përfitimit të pasurive nëpërmjet blerjes si person juridik publik. Neni 64, gërma gj), njeh Kryetarin e Bashkisë si përfaqësues ndaj të tretëve, të Bashkisë si person juridik publik, por gjithësi duke qënë se neni 9. Pika 1.2, gërma c) e ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i jep të drejtë Këshillit të ushtrorë të drejtën e pronarit për pasuritë e Bashkisë, nevojitet autorizimi juaj për ti dhënë të drejtë Kryetarit të Bashkisë të firmosë në emrin tuaj, dispozitat e kontratës bashkangjitur.

Takimet e realizuara me pronarët aktualë të këtyre parcelave kanë sjellë dakortësimin mbi faktin e blerjes së tokës nga ana e bashkisë dhe akordin e tyre për ta shitur. Duke qënë një procedurë blerjeje e drejtpërdrejtë, çmimi është në dakortësinë e palëve (neni 707 Kodi Civil). Për këtë qëllim janë përdorur nga ana jonë, argumentimi i çmimeve të referencës së shitjes së tokave arrë në këtë zonë kadastrale dhe pas konfirmimit të ASHK-së me shkresë nr. 268/1 Prot., datë 31/08/2023 (bashkangjitur), rezultojnë këto çmime shitjeje për tokat e kategorisë arë, si edhe është kategoria e tokave që do të blihen:

- Për sipërfaqe tokë arë 1.800 m² me çmim total 900.000 lek çmim për njësi, **500 lek/m²**.
- Për sipërfaqe tokë arë 645 m² me çmim total 3.225.000 lek çmim për njësi, **5.000 lek/m²**.
- Për sipërfaqe tokë arë 1.516 m² me çmim total 8.000 \$ ose rreth 800.000 lek çmim për njësi, **528 lek/m²**.

Çmimi mesatar i llogaritur për 3 shitjet e realizuara 2 vitet e fundit në zonën kadastrale për kategorinë "tokë arë" rezulton 2.009 lek/m².

Ky çmim i tregut normal është vlerësuar shumë i lartë për tu blerë nga ana e Bashkisë dhe u dakortësua me pronarët e tokave të sipërpërmendura **çmimi prej 366 lek/m²**, çmim ky referencë nga procedura e fundit e shpronësimit me objekt "Ndërtimi i rrugës lidhëse Pogradec–Doganë, loti 2" i shpallur me Kërkesën për shpronësim publik nr. 467/8, datë 23.06.2023. Me pronarët u përdor argumenti se procedura e shpronësimit e sipërpërmendur është në të njëjtën zonë (fshatin Guras) dhe si e tillë nuk mund të kërkohet vlerë më e lartë. Nga krahasimi i vlerave rezulton qartë se **çmimi prej 366 lek/m²**, është disa herë më i favorshëm se vlera e tregut që ekziston sot në këtë zonë dhe e favorshme për Bashkinë Pogradec.

Konkluzioni për këtë vlerë dhe kushtet e blerjes së përcaktuara në kontratën bashkangjitur projekt vendimet janë diskutuar me pronarët të cilët është dakortësuar mbi këto kushte. Kontrata draft e paraqitur është hartuar sipas kritereve që përcakton Kodi Civil për kontratat e shitblerjes. Gjithësesi, kontrata do të ketë formën e përcaktuar nga noteri në momentin e nënshkrimit të saj.

Duke qënë të hapur për cdo sqarim osë saktësim që mund të keni të nevojshëm, ju ftojme në votim.

Ju faleminderit!

Konceptoi: Nexhmi TORRA

Miratoi : Paskalino ZIKO

**KRYETAR
ILIR XHAKOLLI**



KONTRATE SHITJE

(Send i paluajtshem)

Sot më datë _____._____.2023 në Pogradec, përpara meje Noterit, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega vendore KORÇË, me zyrë në adresën Pogradec _____ u paraqitën personalisht palët për lidhjen e kësaj kontrate:

PALET PJESEMARSE NE KONTRATE :

SHITËSI:, i biri i, i datëlindjes _____, lindur në _____ dhe banues në _____, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i identifikuar me Letërnjoftim/pashaporten me nr. _____, me nr. Identiteti _____, i cilësuar më poshtë si "shitësi".

BLERËSI: Bashkia Pogradec, në cilësinë e personit juridik publik, përfaqësuar, në zbatim të gërmës gj), neni 64 i ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen Vendore" dhe nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr. _____, datë ____/____/2023, nga Kryetari i Bashkisë z. Ilir XHAKOLLI, I biri i _____, i datëlindjes _____, lindur në _____ dhe banues në _____, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me Letërnjoftim/pashaporten me nr. _____, me nr. Identiteti _____, i cilësuar më poshtë si "blerësi".

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noteri konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plote, duke iu permbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 83, 705 e vijues i tij, si dhe ligjit nr. 111/2018 "Per Kadastren", neneve 62, 63, 105, 106 - 108, 126, 127 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noteri hartimin e Kontratës së Shitjes Pasuri e Paluajtshme, sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

NENI 1. PERSHKRIMI I OBJEKTIT

Objekti i kësaj kontrate është shitja e një sipërfaqe toke bujqësore e cila është në pronësi të shitësit, e cili ndodhet në Guras, pranë varrezave të reja të qytetit, me sipërfaqe _____ m² (_____). Prona është e regjistruar në ASHK, Zyra Pogradec me të dhëna: ZK: _____, nr. Pasurie: _____, Volum: _____, Faqe: _____ sipas certifikatës për vërtetimin e pronësisë të leshuar nga ASHK-ja Pogradec me nr. Serial: _____ (kopje bashkangjitur) dhe ditën e nënshkrimit të kontratës është e lire nga cdo barre hipotekore vërtetuar me kopje të kartesës së pasurisë bashkangjitur.

Të lidhin këtë kontratë me kushtet e mëposhtme :

Neni 2. Baza ligjore.

1. Baza Ligjore e Kontratës së Shitjes është:



- Kodi Civil, nenet 83, 164, 192, 705, dhe 750 e vijues;
- Kodi i Familjes, nenet 73, 74/a e vijues;
- Ligji 10/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterini", nenet 105/3, 105/4, 105/5 neni 127 e vijues;
- Ligji nr. 111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", neni 42 e vijues;
- ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen Vendore".
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".
- Ligji Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të Ardhurat", I ndryshuar.
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave Vëndore", i ndryshuar.
- Udhezim i përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 20 datë 14.09.2020 "Për procedurën teknike për kryerjen e pagesës në rastet e kalimit të pasurive të paluajtshme",
- Udhezimi nr. 29 datë 30.07.2018 "Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme".

Neni 3. Çmimi i shitjes dhe mënyra e pagesës.

Palët kanë rënë dakord që çmimi i shitjes të jetë në total _____ (_____) LEKE (ose 366 lek/m²) të cilat do të paguhen nëpërmjet llogarisë së noterit në Bankën _____.

Neni 4. Të drejtat dhe detyrimet e shitësit

1. Shitësi ka të drejtë të kërkojë nga blerësi pagimin e çmimit në menyrën dhe afatin e parashikuar në këtë kontratë.
2. Shitësi është i detyruar t'i dorëzojë blerësit të gjithë dokumentacionin që shënon të drejtën e pronësisë dhe që janë të nevojshme për kalimin e saj.
3. Shitësi është i detyruar të dorëzojë tokën objekt kontrate, në gjëndjen që është në momentin e lidhjes së kontratës.
4. Shitësi duhet të garantojë blerësin për gëzimin e qetë të sendit të lirë nga çdo e drejtë pronësie të personave të tretë. Shitësi është i detyruar të marrë pjesë në gjykim në mbështetje të blerësit nëse ai thirret prej tij, për ta garantuar ndaj pretendimeve të personave të tretë, mbi sendin objekt kontrate. Në rast se blerësit i meret sendi, shitësi është i detyruar t'i kthejë çmimin e paguar atij si dhe shpërblimin e dëmit.
5. Shitësi është i detyruar të garantojë blerësin për cilësinë e sendit dhe mungesën e të metave.

Neni 5. Te drejtat dhe detyrat e blerësit

1. Blerësi ka të drejtë të kërkojë dorëzimin e sendit dhe dokumentat që vërtetojnë pronësinë e shitësit mbi to, objekt kontrate, nga shitësi nga e nesërmja e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.
2. Blerësi është i detyruar të marrë sendin në dorëzim, në afatin e parashikuar në këtë kontratë.
3. Blerësi është i detyruar të marrë sendin në dorëzim në vendin ku ndodhet sendi objekt kontrate.



Neni 6. Zgjidhja e kontrates.

Kur midis palëve nuk arrihet zgjidhja me mirëkuptim ose ndermjetesim, secila prej tyre mund ti drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit gjyqësor kompetente.

ANEKSET E KONTRATES

Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Aneke të Kontrates:

- Certifikatë per Vertetim Pronesie,
- Harta treguese,
- Kartela e Pasurise,
- Dok. e identifikimit të palëve.

DISPOZITAT PER FUNDIMTARE

Kontrata e Shitjes pasuri e paluajtshme, u hartua në gjuhën shqipe prej meje Noterit në 4 (katër) kopje, me vlera të njëjta juridike, mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të palëve kontraktuese. Njëra kopje vendoset në arshivën noteriale, një kopje depozitohet në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ASHK, dega vendore Pogradec për t'u regjistruar dhe dy kopjet e tjere u vihen në dispozicion respektivisht palëve kontraktuese.

Kontrata e Shitjes pasuri e paluajtshme, u lexua nga unë Noteri me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilet më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqënëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noterit. Unë Noteri, verifikova identitetin e palëve kontraktuese nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipem, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në menyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITËSI

BLERËSI
Për Bashkinë Pogradec
KRYETAR I BASHKISË
Ilir XHAKOLLI

NOTER

BASHKIA POGRADEC
NR 3488/1
DAT 09.09.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA VENDORE POGRADEC

Nr. 2518/Prot.

Pogradec, më 31.08.2023

LËNDA: KTHIM PËRGJIGJE

DREJTUAR: BASHKIA POGRADEC,
DREJTORIA VENDORE E P.K.ZH.T.

Adresa: Bulevardi Reshit Çollaku, Lagjia Nr. 2, Pogradec.

Gjatë shqyrtimit të "Kërkesës për Informacion" Nr 3488 prot datë 28.08.2023, administruar pranë DVASHK Pogradec Nr 2518 prot datë 30.08.2023, ku kërkoni informacion lidhur me çmimin mesatar për zonën e varrezave të reja të qytetit, pranë fshatit Gurras, ju informojmë se bashkëlidhur kësaj shkresë do të gjeni informacion në formë tabelare përsa I përket çmimit referencë sipas kontratave të shitjes për llojin e pasurisë arë dhe truall në fshatin Guras.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Koncp: B. Flamuri

Brunlida
Flamuri

Digitally signed by
Brunlida Flamuri
Date: 2023.08.31
09:23:41 +0200

DREJTOR
ZHULJEN MANELLARI
ME URDHËR DHE DELEGIM

ZV DREJTOR
SUADA AGALLIU

Suada
Agalliu

Digitally signed by
Suada Agalliu
Date: 2023.08.31
09:30:40 +0200



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Pogradec
Date: 2023/08/31 10:40:14 +0200
19mPOGRADEC2023083110400744014

Drejtoria Vendore e ASHK-së Pogradec, Adresa: Lagjia Nr. 2, kati 2-të (Bashkia Pogradec)

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISE SE PALUAJTSHME

CERTIFIKATË PËR VERTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit POGRADEC Zona Kadastrale Nr. 1711
 Numri i Pasurisë 321/20 Volumi 15 Faqe 79
 Adresa e Pasurisë GESHTE NJAS
 Lloji i Pasurisë ARE
 Sipërfaqja Totale 800 m²
 Nga kjo Sa Truat — Nga kjo Sa Ndërtesa —
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes — %

KJO CERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotënnjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
<u>SELANIN</u>	<u>NEKI</u>	<u>PURBA</u>	<u>—</u>	<u>BACALLEK</u>
/	/	/	/	/
/	/	/	/	/
/	/	/	/	/
/	/	/	/	/

është pronar i —
 janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart —
 është përfqësues i familjes e cila ka në pronësi PASURINE 321/20
 kufizimet e pasurisë janë V 311 L 321/21 J 173/1 P 321/4

Kjo certifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

Kjo certifikatë lëshohet sipas kërkesës së parangitur nga i (të) interesuari (t) me datë 21.08.2003 Nr. 2555

Data e lëshimit të certifikatës

10 SHTATOR 2003

Lëshuesi i certifikatës
REGJISTRUESI

JOKOL DIBRALI

FIARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

ZYRA E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUAJSHIME

POGRADEC



A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 1711 NR. I PASURISE 321/20 VOLI 5 FU 71

INDEKSI I FIARTES K-34-44(82-8) SHKALLA 1:12500

ADRESA E PASURISE: Rrethi POGRADEC Q/Ë BEJUTENI

Rr/L _____ P/G _____ Sh _____ K _____ Ap _____

B. KUFIZIMET

V. 311

L. 321/21


J. 173/1

P. 321/4

C. PRONARI

Sehadet Purbaj

D. Data: 22/09/03 Orë: 10





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME



**ÇERTIFIKATË
PËR VERTETIM PRONËSIE**

Zyra e Regjistrimit POGRADEC Zona Kadastrale Nr. R11
 Numri i Pasurisë 321/21 Volumi 15 Faqe 80
 Adresa e Pasurisë GESHTENJAS
 Lloji i Pasurisë ARE
 Sipërfaqja Totale 1090 m²
 Nga kjo : Sa Truall - Nga kjo : Sa Ndërtesa -
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërnjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
<u>ENVER</u>	<u>FAZLI</u>	<u>CAPO</u>	<u>-</u>	<u>GESHTENJAS</u>
/	/	/	/	/
/	/	/	/	/
/	/	/	/	/
/	/	/	/	/

- është pronar i _____
 - janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart _____
 - është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi PASURINE 321/21
 - kuizimet e pasurisë janë : V 311 L 321/6 J 173/1 P 321/20

Kjo certifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo certifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 18.08.2003 Nr. 2509

Data e lëshimit të certifikatës

10 SHTATOR 2003


Lëshuesi i certifikatës
REGJISTRUESI
(DOKOL MHAJI)
POGRADEC
AM-TE PASURIT

HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

ZYRA E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUAJSIME

POGRANDEC



A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 17/11 NR. I PASURISE 321/21 VOL. I TQ 80
INDEKSI I HARTES K-24-114 (85-8) SHKALLA 1:2500
ADRESA E PASURISE: Rrethi POGRANDEC Qm. BEHITENJARI
Rr/L _____ F/G _____ Sh _____ K _____ Ap _____

B. KUFIZIMET

V. 3M

L. 321/6

J. 17/11


P. 321/20

C. PRONARI

ENVER CADO



D. Data: 22/09/03 Ora: 10





218/2

320

319/1
319/2

319/3
319/4

319/5
319/6

319/7
319/8

319/9
319/10

319/11
319/12

319/13
319/14

319/15
319/16

319/17
319/18

319/19
319/20

319/21
319/22

319/23
319/24

319/25
319/26

319/27
319/28

319/29
319/30

319/31
319/32

319/33
319/34

314

314

321/2

321/1

321/3

321/4

321/20

321/6

321/21

321/8

321/7

321/9

321/10

321/11

321/12

321/13

321/14

321/15

321/16

314

321/17

173/5

321/22
321/24

311



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME



ÇERTIFIKATË PËR VËRTETIM PRONËSIE

1891173

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. PÓGRADEC Zona Kadastrale Nr. 1711
 Numri i Pasurisë 321/25 Volumi 18 Faqe 233
 Adresa e Pasurisë GESHTEJAS
 Lloji i Pasurisë ARE
 Sipërfaqja Totale 3700:00 m²
 Nga kjo : Sa Truall _____ Nga kjo : Sa Ndërtesa _____
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes _____ %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
ALEKSANDËR	LEFTER	SULKOLLARI	1/7	BUÇIMAS
ALTINA	LEFTER	SULKOLLARI	1/7	BUÇIMAS
IRENA	LEFTER	SULKOLLARI	1/7	BUÇIMAS
LEFTER	GANI	SULKOLLARI	2/7	BUÇIMAS
NIKOLAS	LEFTER	SULKOLLARI	1/7	BUÇIMAS
SHPRESA	AGUSH	SULKOLLARI	1/7	BUÇIMAS

- është pronar i _____ tek pasuria me numër 321/25
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart _____
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi _____
- kufizimet e pasurisë janë : V 314 , L 321/26 , J 173/1 , P 321/7

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 11/12/2019 Nr. 4933

Data e lëshimit të çertifikatës
11/12/2019

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI
NATALIA VELO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME



ÇERTIFIKATË PËR VERTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit Pogradec Zona Kadastrale Nr. 1711
 Numri i Pasurisë 321/6 Volumi 2 Faqe 209
 Adresa e Pasurisë GESHITENJAS
 Lloji i Pasurisë ARE
 Sipërfaqja Totale 1000 m²
 Nga kjo : Sa Truall _____ Nga kjo : Sa Ndërtesa _____
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes _____ %

KUO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VERTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
<u>SAFET</u>	<u>KAMBER</u>	<u>MANOLLARI</u>		<u>GESHITENJAS</u>

- është pronar i _____
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart _____
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi pasurisë 321/6
- kufizimet e pasurisë janë : V 311 , L 321/1 , J 173/1 , P 321/5

Kjo certifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo certifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 22.10.2001 Nr. 7180

Data e lëshimit të certifikatës

27 FETOR 2001

Lëshuesi i certifikatës
REGJISTRUESI

MEHMET KAROLIC

HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

Agjencia Shtetërore e Kadastres
Drejtoria Vendore Pogradec



HARTOGRAF A. Turshinka

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 1711 NR. I PASURISE 321/25 Vol. 18 Fq 233.

INDEKSI I HARTËS K-34-114-(103-B) SHKALLA 2500

ADRESA E PASURISE: Rrethi Pogradec Q/F Geshtenjas
Rr/L P/G Sh K Ap



B. KUFIZIMET

V 314.
L. 321/26.
J. 173/1.
P. 321/7.

C. PRONARI/ET

(B) Lefter Sulkollari

D. Data: 11/12/2019 Ora: _____





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENSIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA VENDORE POGRADEC



Nr. 3201 prot.

Pogradec, më 8 11 2021

Lënda: Informacion

Drejtuar: " BASHKIA POGRADEC "

Në vijim të kërkesës suajës me nr 10516 dt 29.10.2021 drejtuar E. VASHK, Pogradec në të cilën kërkonti "Informacion zyrtar për pasuritë për individet dhe institucionet" për pasurinë nr. 321/10 ne zk 1711 ne Geshtenjas vol 13 fq 12 pasuria e llojit ARE me sip t= 2540 m2 ne pronesi Shtet. Pasuria 321/11 ne zk 1711 ne Geshtenjas vol 13 fq 11 lloji i pasurise ARE me sip t= 1300 m2 ne pronesi te Gafer Ramadan Yzellari. 3- 321/12 vol 13 fq 10 ne zk 1711 ne Geshtenjas pasuria e llojit ARE me sip t= 1440 m2 ne pronesi SHTET. Pasuria 321/13 vol 13 fq 9 ne zk 1711 ne Geshtenjas pasuria e llojit ARE me sip t= 2890 m2 ne pronesi SHTET. 5- 321/5 ne zk 1711 ne Geshtenjas vol 10 fq 231 ne Geshtenjas rezulton te jete e mbyllur. Pasuria 321/7 vol 10 fq 232 ne zk 1711 pasuria ne Geshtenjas e llojit ARE me sip t= 2000 m2 ne pronesi SHTET. Pasuria 321/9 vol 10 fq 233 ne zk 1711 ne Geshtenjas pasuria e llojit ARE me sip t= 2450 m2 ne pronesi te Minir Enver Manellari , Entela Enver Manellari / Lickollari, Mine Nazmi Manellari, Blerina Minir Manellari, Juliana Minir Manellari/ Lickollari, Ermal Minir Manellari, Mimoza Enver Manellari/ Lickollari, Ylbere Enver Manellari/ Purba. Pasuria nr. 321/6 vol 2 fq 209 ne zk 1711 ne Geshtenjas pasuria e llojit ARE me sip t=4954 m2 ne pronesi te Safet Karber Manellari. Pasuria 321/16 vol 9 fq 80 ne zk 1711 ne Geshtenjas lloji i pasurise ARE me sip t= 2400 m2 ne pronesi te Zafir Xhezmir Zacellari. Pasuria 321/17 vol 13 fq 8 ne zk 1711 ne Geshtenjas lloji i pasurise Are me sip t= 3300 m2 ne pronesi te SHTET. Pasuria 321/5 ne zk 1711 ne Geshtenjas vol 8 fq 207 pasuria e llojit ARE me sip t= 2600 m2 ne pronesi te Avni Dilaver Hysenllari. Pasuria 321/14 nuk rezulton te kete karteles pasurie te hapur. Pasuria 10/1 ne zk 3665 ne Udenisht nuk rezulton te kete karteles pasurie te hapur. Pasuria nr. 14/482 ne zk 8581 ne Pogradec vol 17 fq 209 lloji i pasurise TRUALL me sip t= 3173 m2 ne pronesi te Bashkia Pogradec.

